

### **AGJENCIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE ELBASAN**

1. Emri dhe adresa e Autoritetit Kontraktor

Emri Agjencia e Shërbimeve Publike, Bashkia Elbasan

Adresa Lagjja "Shkumbini", Elbasan

Tel/Faks (+355) 58 523312

E-mail ashp@elbasani.gov.al

Ueb-faqe www.elbasani.gov.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Procedurë e Hapur – Marrëveshje Kuadër.

3. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-56374-01-19-2023

Loti I: REF-56386-01-19-2023

Loti II: REF-56388-01-19-2023

4. Objekti i kontratës: "Blerje Karburant për ASHP, QEA, QSB, SHMZSH dhe Terrenet Sportive", Marrëveshje Kuadër - me disa operatorë ekonomikë ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj, i ndarë në lote si mëposhtë:

Loti I: "Blerje Gazoil D1 për ASHP, QSB, QEA, SHMZSH dhe Terrenet Sportive"

Loti II: "Blerje Benzinë pa plumb për ASHP dhe Terrenet Sportive"

5. Fondi limit: 31.208.333 (tridhjetë e njëmilion e dyqind e tetemije e treqind e tridhjetë tre) lekë pa t.v.sh., vënë në dispozicion nga Buxheti I Agjencisë së Shërbimeve Publike, Bashkia Elbasan për vitin 2023, i ndarë në lote si mëposhtë:

LOTI I: "Blerje Gazoil D1 për ASHP, QSB, QEA, SHMZSH dhe Terrenet Sportive" me fond limit : 30.291.667 ( tridhjetemilion e dyqind e nëntëdhjetë e njëmije e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa tvsh. Ky fond përbën vlerën e pritshme të kontrave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër.

Loti II: "Blerje Benzinë pa plumb për ASHP dhe Terrenet Sportive" , me fond limit: 916.666 (nëntëqind e gjashtëmbëdhjetëmije e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë ) lekë pa tvsh. Ky fond përbën vlerën e pritshme të kontrave që mund të lidhen gjatë marrëveshjes kuadër.

**1. "AD OIL" sh.p.k. me Nipt: L43611201A**

**Me oferte prej 30.291.667** ( tridhjetemilion e dyqind e nëntëdhjete e njëmije e gjashtëqind e gjashtëdhjete e shtatë) **lekë pa tvsh. dhe me marzhi fitimi prej 10.80 lekë/litër .**

**2. "Kastrati" sh.p.k me Nipt: J61813529P**

**Me oferte prej 30.291.667** ( tridhjetemilion e dyqind e nëntëdhjete e njëmije e gjashtëqind e gjashtëdhjete e shtatë) **lekë pa tvsh. dhe me marzhi fitimi prej 17,00 lekë/litër.**

**3. "Gega Center GKG" sh.p.k. me Nipt: K66801001T**

**Me oferte prej 30.291.667** ( tridhjetemilion e dyqind e nëntëdhjete e njëmije e gjashtëqind e gjashtëdhjete e shtatë) **lekë pa tvsh. dhe me marzhi fitimi prej 25,00 lekë/litër .**

**Operatorë ekonomikë të skualifikuar "Kastrati" sh.p.k me Nipt: J 61813529 P, dhe "Gega Center GKG" sh.p.k. me Nipt: K66801001T skulifikuar për arsyet e mëposhtme:**

**1. "Gega Center GKG" sh.p.k.**

1. Nuk keni paraqitur asnjë dokumentacion që të vërtetojë se keni 1 pikë karburanti nëpër aksin Elbasan- Librazhd apo Elbasan-Cërrik, duke mos përmbushur kërkesën e parashikuar në pikën 2.3.3 të kapacitetit teknik, të kriterëve të veçanta për kualifikim ku kërkohet:

2.3.3 Të ketë në pronësi ose me qera 3(tre) pika karburanti, të cilat duhet të kene detyrimisht vendodhje si me poshte:

1 pike brenda qytetit të Elbasanit;

1 pike neper aksin Elbasan- Librazhd apo Elbasan-Cerrik;

1 pike neper aksin Elbasan-Tirane apo Elbasan – Durres.

2. Keni paraqitur licencën me nr.2/2023 për pikën e karburantit me vendndodhje rruga Elbasan- Papër. Kjo licencë është e pa firmosur nga titullari i institucionit (organi publik) si dhe pa vulën e institucionit, duke e bërë këtë dokument të pavlefshëm ligjërisht siç edhe parashikohet në nenin 98 e vijues të ligjit nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative". Sa mësipër, nuk përmbushni kërkesën e parashikuar në pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik, të kriterëve të veçanta për kualifikim ku kërkohet:

Në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, neni 82 parashikohet se: Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Në ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 76 pika 3 gërma ë), ndër të tjera parashikohet se autoriteti kontraktor skualifikon çdo operator, i cili nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **"AD OIL" sh.p.k.** me adresë: Elbasan Paper PAPER Fshati Paper, rruga automobilistike Elbasan-Peqin km 7, se oferta e paraqitur me vlerë : marzhi i fitimit i shprehur në vlerë absolute 10,80 lekë/litër është identifikuar si fitues (paraprak) i procedurës së prokurimit.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".